



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.607/5 prot.

Datë 06.03.2026

V E N D I M

Nr. 357/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Kryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*” me nr. REF-76593-02-18-2026, me objekt: “*Loti 1: “Pjese këmbimi për DVP Durrës*”, me fond limit 2,000,000.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 02-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
- Ankimues:** “ALSTEZO” SHA me NIPT J63208420N dhe adresë: ZHUPAN, Fier.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit*”

Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19-02-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-76593-02-18-2026, me objekt: “Loti 1: “Pjese këmbimi për DVP Durrës”, me fond limit 2,000,000.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 02-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 25.02.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me numër online të ankeses A/2026/6364 dhe protokolluar me tonën me nr. 607/2026, datë 25.02.2026 e operatorit ekonomik “ALSTEZO” SHA, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në pikën 2 të nenit 112, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë.

II.4. Nëpërmjet shkresës me nr.772/5, datë 03.03.2026 si dhe protokolluar me tonën nr. 607/1 prot., datë 04.03.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “ALSTEZO” SHA. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ALSTEZO” SHA dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur refuzimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ALSTEZO” SHA mbi kriteret e përcaktuar në dokumentet e tenderit konkretisht për pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 për të cilat ka kërkuar modifikim, me pretendimin se: *“Mbi pasaktësitë teknike të kriterëve aktuale ? Kriteret aktuale përdorin në mënyrë të njëjtësuar termat ikatalog / broshurë / skedë teknikeë, të cilat nuk janë dokumente ekuivalente nga pikëpamja teknike. Se pari: i broshuraë është, në thelb, material promovues/marketing dhe jo domosdoshmërisht dokument teknik i plotë e i verifikueshëm. I skeda teknike (datasheet)ë përshkruan karakteristika fizike/funksionale të produktit (p.sh. Peshë, dimensione, materiale, toleranca, kushte pune), por nuk është dokument identifikimi unik i pjesës dhe nuk garanton aplikueshmërinë e saktë në mjetin konkret. Ne këtë procedurë, verifikimi që i duhet AK-së nuk është i struktura e prodhimit e pjesës, por identiteti i pjesës dhe aplikueshmëria e saj e saktë. ? Në praktikën e industrisë automotive, identifikimi i saktë i pjesës së këmbimit ne shitje , apo ne blerje të cilat ne fakt nxirren nepermjet nr. Shasisë, bëhet përmes kodit origjinal të prodhuesit (OE number) i cili është UNIK dhe i patjetersueshem si dhe përmes skemës origjinale teknike të montimit (parts diagram/EPC) e cila tregon pozicionin e pjesës në mjet dhe lidhjen në perputhshmerine e saj me aplikimin konkret Sa me siper, sqarojme qe: i vetmi identifikues unik dhe i pandryshueshëm është OE number . Termi i part numberë i përdorur nga AK, pa e përcaktuar se i referohet OE number, është evaziv dhe lejon që të paraqiten kode të ndryshme (distributor/aftermarket/kod i brendshëm), që nuk janë unikë dhe mund të ndryshojnë ndërmjet operatorëve, duke e bërë të pamundur krahasimin real dhe verifikimin objektiv. ? Kërkesa për*

ëmbrin e katalogutë dhe inumrin e faqesë është formale dhe jo universale, pasi sqarojme qe shumë prodhues ose distributorë SOT përdorin datasheet ose dokumentacion online ose formate që nuk kanë ikatalog klasik me faqeë. Kjo kërkesë rrezikon skualifikime për arsye formale (p.sh. Ìfaqeë), në vend që të vlerësohet thelbi teknik (identifikimi i saktë i pjesës dhe përputhshmëria). Përveç kesaj edhe katalogu duhet te jete nje dokument teknik i zyrtarizuar, pra leshuar nga prodhuesi / distributori i autorizuar dhe jo i sajuar/improvizuar nga vet operatori ekonomik ofertues, pasi kjo forme eshte nje vetpershtatje qe dmth nje katalog i adoptuar te cilin mund ta Ìimprovizojë vet OE per te bere te mundur kualifikimin e tij ne varesi edhe te kerkeses vendosur nga AK ne DT. Nëse nuk përcaktohet qartë standardi i dokumentit (originjë/verifikueshmëri/referencë OE), ekziston rreziku praktik që operatorë të ndryshëm të paraqesin ikatalogëë të përgatitur/mbledhur vetë, duke ulur provueshmërinë dhe duke rritur hapësirën për vlerësim subjektiv”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Formular i i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit, pika “2.3. Kapaciteti teknik” parashikon pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 si më poshtë vijon:
[...]

“Shtojca 8”

“FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”

4. Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen emërtimet dhe specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me artikujt objekt prokurimi.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike për artikujt e kërkuar, në formë tabelle, ku të plotesohet: Emërtimi i artikullit, specifikimet teknike, kompania prodhuese, vendi i origjinës, kodi i artikullit (part number), emri i katalogut, nr. i faqes në katalogun përkatës.”

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” i ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të

barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e autoritetit kontraktor në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të autoritetit kontraktor nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj”.*

III.1.5. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:
1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.’

III.1.6. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.1.8. Në rastin konkret lidhur me pretendimet më sipër të operatorit ekonomik ankimues dhe mbi kërkesën e autoriteti kontraktor për të vërtetuar se mallrat që oferton në këtë procedurë do të jenë origjinale ka kërkuar “*të paraqiten katalog / broshurë / skedë teknike për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen emërtimet dhe specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me artikujt objekt prokurimi”, si dhe “të paraqesë ofertën teknike për artikujt e kërkuar, në formë tabele, ku të plotësohet: Emërtimi i artikullit, specifikimet teknike, kompania prodhuese, vendi i origjinës, kodi i artikullit (part number), emri i katalogut / skedës teknike / broshurës, nr. i faqes në katalogun / skedën / broshurën përkatëse”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa e mësipërme i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, për artikujt objekt prokurimi. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, vetëm këto kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik dhe kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të katalogeve skedave ose broshurave, **prandaj** është e përshtatshme dhe nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e synimit sepse ashtu sic dhe argumentuar nga autoriteti kontraktor “**Qëllimi i kriterit nuk është forma e dokumentit, por përmbajtja e tij, pra vërtetimi i specifikimeve teknike të produktit. Përderisa informacioni teknik është i qartë, i verifikueshëm dhe i markuar sipas Shtojcës 6, forma e dokumentit (katalog, broshurë apo skedë teknike) nuk cenon thelbin e kërkesës, së pretenduar nga operatori ekonomik ankimues...Ndërsa për kërkesën e parashikuar sipas pikës 5 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit..., kjo kërkesë përbën një mekanizëm thelbësor për **garantimin e saktësisë, transparencës dhe verifikueshmërisë së ofertës teknike...Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave citon se skeda teknike është dokumenti më i drejtpërdrejtë dhe më i saktë për një model të caktuar, pasi përmban kodin unik të produktit, versionin, parametrat teknikë të detajuar dhe shpesh referencat e aplikueshmërisë.**”, nuk mund të vërehet qartë plotësimi i garancisë që autoriteti kontraktor kërkon për mallrat që të vijnë nga kompani serioze që tregtojnë produkte origjinale sipas specifikimeve teknike, pa pasur nevojë të vihet në dispozicion **informacioni i kërkuar sipas tabelës përcaktuar e cila mban të dhëna mbi kompaninë nga ku operatori ekonomik do të furnizohet.** Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është autoriteti kontraktor organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere dhe specifikime të mallit që janë në funksion të marrjes së një produkti cilësor dhe në përputhje me pritshmëritë e autoritetit dhe realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.***

Sa më lart pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ALSTEZO” SHA mbi dokumentat e tenderit, *“Nderkohe ne DT , ne NJOFTIMIN E KONTRATËS, Pika 2.10 përshkrimi i shkurtër i kontratës / marrëveshjes kuadër , thuhet: 2. NË rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e Cmimeve për njësi është: Nuk aplikohet. ? Nderkohe qe ne DT, perkatesisht në: Shtojcen 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE dhe Shtojcen 7 FORMULARI I SASISÀ DHE GRAFIKUT TÀ LÀVRIMIT, eshte kerkuar, si me poshtë është sëlasia e parashikuar për 24 muajë për të gjithë artikujt në tabelën pjesë kembimi është : Sasia ëlë Sa me sipër, kerkojme të sqarohet dhe sistemohet kjo kerkese pasi është e pa sakte dhe krijon konfuzion, si në vlerësim, ashtu dhe në zbatim të kontratës për OE fitues përfundimtar.”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se objekti i pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, në thelb ka të bëjë me një paqartësi dhe kërkesa për sqarime mbi përmbushjen dhe zbatimin e kontratës për procedurën e sipërcituar. KPP konstaton se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka dhënë sqarime për së është kërkuar në ankesë. Në nenin 75 të LPP-së parashikohet shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”* Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor këto sqarime të cilat i ka parashtruar në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues duhet ti publikojë në SPE, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së, si më sipër cituar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikës 1 dhe 3 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ALSTEZO” SHA për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-76593-02-18-2026, me objekt: “Loti I: “Pjese këmbimi për DVP Durrës”, me fond limit 2,000,000.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 02-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik dhe KSHA-së.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kalimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “ALSTEZO” SHA në buxhetin e shtetit.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

